

-Sa është numri i vendeve të lira të punës të shpallura për këtë vit? Sa vende bosh ishin vjet?

Gjatë periudhës Janar- Korrik 2023 u shpallën 34,871 vende të lira pune ose rreth +50% më shumë se njëjta periudhë e një viti më parë.

-Cilët janë sektorët që kërkojnë më shumë punonjës?

Gjatë 7 mujorit 2023 sektorët ekonomik të cilët shpallën më shumë VLP ishin industria përpunuese, akomodimi dhe shërbimi ushqimor, tregtia me shumicë dhe pakicë, aktivitete të tjera shërbimi dhe ndërtimi përkatësisht me 36%, 16%, 13%, 10% dhe 8% të totalit të VLP-ve të shpallura.

-Sa është numri i punonjësve të regjistruar si punëkërkuar gjatë këtij viti? Sa ishte numri vjet?

Numri mesatar (stoku) punëkërkuarve të papunë të regjistruar në zyrat e punësimit për 7 mujorin 2023 ishte 77,907 pu.pa, nga 76,879 pu.pa që rezultonin të regjistruar në vitin 2022.

-Cilat janë të dhënat sipas llojeve të papunësisë, kategoritë që kërkojnë punë?

Prej totalit të papunësisë së regjistruar rezultojnë:

- 23% pu.pa 15-29
- 55% janë me arsim deri 9 vjeçar
- 54% janë femra
- 31% përfitues të ndihmës ekonomike
- 9% rom/ egjiptian
- 1% aftesi e kufizuar

-Për çfarë pozicioni pune interesohen më shumë dhe më pak qytetarët?

Prej totalit të papunësisë së regjistruar sipas kategorive profesionale rezultojnë:

- 29% pu.pa në kategorinë e profesioneve elementare
- 27% punonjës të shitjeve dhe shërbimeve
- 19% zejtarë dhe zanatçinj
- 7% specialist me arsim të lartë

-Cilat janë disa nga shkaqet e papunësisë?

Procesi i integritit të pu.pa-ve në tregun e punës has pengesa të ndryshme lidhur më aftësitë, moshën, statusin social, vendbanimin etj.

Duke e analizuar regjistrin e pu.pa-ve sipas moshës dhe arsimit, vihet re se rreth 45% e totalit të pu.pa-ve janë mbi 45 vjeç dhe 55% me arsim deri 9 vjeçar, çka e vështirëson integrimin e këtyre pu.pa-ve në tregun e punës. Kjo tendencë është me e theksuar në grupet e veçanta.

- Sa aplikime janë bërë pranë AKPA, janar-shtator 2023 nga shtetas të huaj për leje pune? Sa ishin vitin e kaluar?

Ju bëjmë me dije se këto të dhëna janë vetëm për procesin e aplikimeve për pajisje me leje unike (qëndrimi me motiv punësimi) Pranuar janë të gjithë aplikimet që kanë marrë miratimin për punësim nga AKPA. Autoriteti përgjegjës për lëshimin final të lejes unike është Drejtoria për Kufirin dhe Migracionin.

Për periudhën Janar- 15 Shtator 2023 rezultojnë gjithsej 9,036 aplikime.

Gjatë vitit 2022, janë pajisur me leje dhe vërtetime pune 8,305 shtetas të huaj.

- Sa aplikime janë pranuar, pra janë pajisur me leje?

Gjatë 9 mujorit 2023 kanë marrë statusin pranuar nga AKPA 5,799 aplikime.

- Nga cilat shtete janë personat që kanë aplikuar për leje? Kush kryeson?

Prej totalit të lejeve të miratuara sipas shtetësisë rezultojnë:

- 15% Turq
- 14% Bangladeshi
- 12% Indianë
- 9% Nepali
- 7% Italianë

- Në cilët sektorë janë përqendruar më së shumti?

Prej totalit të lejeve të miratuara sipas aktiviteteve ekonomike rezultojnë:

- 23% në industrinë përpunuese
- 14% në akomodim dhe shërbim ushqimor
- 8% në aktivitete të tjera shërbimi
- 8% në ndërtim

- A ka pasur revokim të lejes së dhënë për punë gjatë kësaj periudhë? Nëse po, për çfarë arsye?

Gjatë 9 mujorit 2023 kanë marrë statusin refuzuar nga AKPA 3,237 aplikime.

Ndër arsyet e refuzimeve përmendim:

- mungesë dokumentacioni
- aplikime të përsëritura
- me kërkesë të subjektit
- detyrime tatimore të papaguara

- Sa është numri i nxënëseve të diplomuar në shkollat profesionale gjatë viteve 2019-2022? Cilat ishin degët kryesore dhe a ka të dhëna mbi punësimin e tyre aktualisht?

Tabela në vijim paraqet numrin e maturantëve të diplomuar gjatë viteve shkollore 2019-2022 dhe rezultatet e gjurmimit për nivelin e punësueshmërisë së të diplomuarve në arsimin profesional.

Degët kryesore të të diplomuarve janë : Hoteleri Turizëm, Teknologji Informacioni dhe Komunikimi, Shërbime Mjete Transporti etj.

| | 2020-2021 | 2021-2022 |
|---|------------------|------------------|
| Numri i maturantëve të diplomuar në arsimin profesional | 3,831 | 3,676 |
| Rezultati i punësueshmërisë nga procesi i gjurmimit brenda 6 muajve të parë nga diplomimi | 57% | 60% |